



Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Prade – Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë – Kancelarija Ministra Pravde – Cabinet of the Minister of Justice

Nr. 14 /2025

Datë: 14 / 01 /2025

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, (GZ/Nr. 7/01 mars 2019), në bazë të nenit 11 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 5 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3) të Ligjit nr. 08/L-175 për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, në bazë të nenit 6 (paragrafi 6) të Rregullores (QRK)-Nr. 15/2024 për klasifikimin, ndryshimin e statusit të klasifikimit, asgjësimin dhe shkatërrimin e informacionit të klasifikuar, si dhe në përputhje me Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores QRK-nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, Ministria e Drejtësisë, ai autoritet klasifikues, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet lista e funksioneve/pozitave që për shkak të detyrave zyrtare prodhojnë informacion të klasifikuar ose gjatë bashkëpunimit me institucione të tjera e përfitojnë këtë kategori informacioni në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.
2. Shtojcë e këtij vendimi është Lista e funksioneve/pozitave sipas pikës 1 të këtij vendimi.
3. Me këtë vendim njoftohet Agjencia për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar (AMIK).
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albulena HAXHIU

Ministre e Drejtësisë

Vendimi iu dërgohet:

- *Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;*
- *Sekretares së Përgjithshme/MD;*
- *Agjencisë për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar (AMIK); dhe*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*